



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2019:282116

Datë: 10.05.2024

Numri i dokumentit: 05735259

KA.nr.62/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtari Arben Toska, në konfliktin administrativ të paditësit “Institucioni Mikrofinanciar FINCA” me NUI 811822081 dhe seli në rrugën “Robert Doll”, nr.5 në Prishtinë, i cili përfaqësohet sipas prokurës nga avokatët Gazmend Nushi dhe Ahmet Hasolli nga zyra ligjore “Kalo Associates Kosovë” me seli në rrugën “Mujo Ulqinaku” nr.5/1 në Prishtinë, kundër të paditurit Banka Qendrore e Kosovës, i cili përfaqësohet sipas prokurës nga shoqëria e avokatëve RPHS LAW LLC, objekti i kontesti anulimi i aktit administrativ, pas seancës publike të shqyrtimit kryesor të datës 29.04.2024 në të cilën pjesë përfaqësuesit e të dy palëve, më 10 maj 2024 dha këtë:

A K T G J Y K I M

- I. Refuzohet si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit “Institucioni Mikrofinanciar “FINCA” me NUI 811822081, ndaj të paditurit Banka Qendrore e Kosovës, në lidhje me anulimin e pikës I, II. dhe IV. të vendimit nr. 06-04/2019 i datës 22.07.2014 i të paditurës Banka Qendrore e Kosovës dhe kthimin e shumës prej 15,000.00€ në emër të dënimit administrativ së bashku me interesin prej 8% duke filluar nga data 30.07.2014.
- II. Hedhet poshtë padia e paditësit “Institucioni Mikrofinanciar “FINCA” me NUI 811822081, ndaj të paditurit Banka Qendrore e Kosovës, në lidhje me pikën III. të vendimit nr. 06-04/2019 i datës 22.07.2014 i të paditurës Banka Qendrore e Kosovës.

A R S Y E T I M

I. Padia, kërkesëpadia dhe pretendimet e palëve

1. Paditësi përmes padisë së datës 07.03.2019 e ka iniciuar konfliktin administrativ me kërkesë për anulimin e tërësishëm të vendimit nr. 06-04/2019 i datës 22 korrik 2014 i të paditurës Banka Qendrore e Kosovës. Ai më 20.03.2023 gjatë seancës së shqyrtimit

kryesor e ndryshoi padinë, ashtu që kërkoi krahas anulimit të vendimit të cekur më lartë edhe kthimin e shumës prej 15,000.00€ në emër të dënimit të paguar, me kamatëvonesë prej 8% nga data 30.07.2014, si datë e paraqitjes së padisë.

2. Ai në padi por edhe gjatë seancës për shqyrtimin e kryesore të çështjes, si dhe në fjalën përfundimtare ka pretenduar se, më datë 24.04.2014 nëpërmjet kërkesës përkatëse e kishte njoftuar të paditurën për zhvendosjen e zyrës së saj në Kamenicë në adresë tjetër, duke e kërkuar aprovimin e kësaj zhvendosje si kërkesë e parashtruar 32 ditë më herët duke e pasur parasysh nenin 3.6 të Rregullores për hapjen dhe mbylljen brenda dhe jashtë Republikës së Kosovës të degëve dhe subjekteve të varura të bankave, sipas së cilës inspektimi i zyrës së zhvendosur duhet të bëhet brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të kërkesës, ndërsa e paditura ka kryer inspektim më datë 26.05.2014 duke e shkelur afatin prej 30 (tridhjetë) ditor të përcaktuar me nenin 3.6 të rregullores së cekur më lartë, si dhe duke e njoftuar atë pas 76 ditësh se i është aprovuar kërkesa për zhvendosje.
3. Ka shtuar se më datë 25.07.2014 Paditësi para se të pranoj aprovimin nga e paditura ka pranuar vendimin e të paditurës nr. 46-15/2014 të datës 22.07.2014, me të cilin i është shqiptuar dënimi në të holla prej 15,00.00€, kurse menaxhmentit vërejtje me shkrim për shkak të fillimit të aktivitetit në zyrën e zhvendosur pa aprovim paraprak, Ka shtuar se më 29.07.2014 e kishte paguar gjobën e ngarkuar, ndërsa kundër këtij vendimi ka iniciuar konflikt administrativ.
4. Sipas tij, i Padituri më datë 26.09.2013 e ka aprovuar “Rregulloren për procedurat e shqiptimit të ndëshkimeve administrative”, e cila në nenet 4 dhe 5 të ka paraparë që para shqiptimit të gjobës eventuale, të zhvillohet procedura paraprake në formën e “Rekomandimeve për marrjen e masave ndëshkimore administrative”. Në këtë drejtim, sipas tij neni 4.3 i rregullores së cekur më lartë, i Padituri ka qenë i obliguar që këtë rekomandim fillimisht t’ia dorëzoj Paditësit, i cili pastaj në afat prej 15 ditëve ka pasur kohë të parashtrroj kërkesën për rishqyrtim, ndërsa pasi që rekomandimi të bëhej i plotfuqishëm, e paditura ka mundur të shqiptoj dënimin administrativ. Ka theksuar se vendimi i kontestuar me padi është i kundërligjshëm konform nenit 52 pika 1.3 të LPPA-së, sipas të cilit një akt administrativ është i kundërligjshëm nëse është rezultat i shkeljes së dispozitave lidhur me procedurën administrative, si dhe neni 13 pika 1 e rregullores së BQK-së, sipas të cilës vendimi për shqiptimin e ndëshkimeve administrative duhet të jetë në përputhje me LPPA-në. Ka shtuar sei Padituri ka qenë i

obliguar që brenda afatit prej 30 ditësh ose deri më datë 24.05.2014, jo vetëm të bëj inspektimin por të merr vendim për aprovim apo refuzim të kërkesës, ndërsa vendimin i Paditura e ka marr sipas shkresës më 05.08.2014, ndërsa ia ka dorëzuar atij më 11.08.2014, gjegjësisht 78 ditë me vonesë, duke rezultuar në shkelje procedurale të procedurës administrative. Gjithashtu ka pretenduar se nëse krahasohet vendimi i atakuar me vendimin paraprak të saj të anuluar, lehtë konstatohet se janë identike dhe përsëritëse duke dëshmuar faktin se e paditura fare nuk i ka marr në konsideratë qëndrimet dhe vërejtjet e gjykatës. Për fund ka deklaruar se dënimi në vlerë prej 15.000.00€ ka ardhur si rezultat i mos vërtetimit të plotë të gjendjes faktike nga i Padituri.

5. I padituri në përgjigje e tij në padi dhe gjatë gjithë procedurës e ka kundërshtuar kërkesëpadinë e Paditësit dhe i ka kërkuar gjykatës që ta refuzoj atë. Ka theksuar se në riprocedurë duke vepruar sipas vërejtjeve të gjykatës ka nxjerr aktin e ri, gjegjësisht vendimin nr. 06-04/2019 duke vërtetuar drejtë gjendjen faktike mbi shkeljet e konstatuara të Paditësit në raportin e inspektimit të datës 08.02.2019, si dhe për caktimin e lartësisë së gjobës së paditësit në vlerë prej 15,000.00€, e ka zbatuar dispozitat e Ligjit nr. 04/L-093 për Bankat, Institucionet Microfinanciare, dhe Institucionet Financiare Jobankare, konkretisht neni 105 para.1 nënpar.1.1 dhe 1.6. Sipas tij, pretendimet e Paditësit se i Padituri nuk ka vepruar sipas rregullores për procedurat e ndëshkimeve administrative konkretisht neni 4 dhe 5, sipas të cilave parashihet se para shqiptimit të gjobës zhvillohet procedura paraprake në formë e rekomandimit, janë tërësisht të pa bazuara, për faktin se Paditësi kishte filluar me operimin e zyrave “IMF Finca” në Kamenicë pa aprovim paraprak të BQK-së duke vepruar në kundërshtim me nenin 95 par.1 nënpar. 1.2 të ligjit të cekur më lartë, i cili shprehimisht përcaktohet se ndryshimi i lokacionit të institucionit microfinanciar është transaksion që kërkon miratimin paraprak nga BQK-ja. Sa i përket aspektit procedural, i Padituri ka deklaruar se kishte vendosur të veproj konform nenit 67 para.5 të Ligjit për BQK-në, i cili përcakton se Bordi Ekzekutiv nuk kërkohet të zbatoj para.4 të këtij neni kur përcakton ndëshkimet e përmendur në nenin 23 të Ligjit për BQK-në.
6. Përveç kësaj, ka shtuar se pretendimi i Paditësit se nuk ka vepruar sipas rregullave të procedurës dhe afatit të përcaktuar me rregulloren për hapjen dhe mbylljen e zyrave brenda dhe jashtë RKS-së të degëve dhe subjekteve të varura të bankave janë tërësisht të pa bazuara për faktin se rregullorja në fjalë sipas nenit 1 para.2, zbatohet për të gjitha

bankat e licencuara nga BQK-ja, ndërsa Paditësi është institucion mikrofinanciar dhe jo bankë. Për më tepër neni 3 par. 6 i rregullores parasheh se brenda 30 (tridhjetë) ditësh kalendarike nga data e pranimit të kërkesës së kompletuar për licencë të degës BQK-ja do ta miratoj apo refuzoj atë, pra afati 30 ditor i shqyrtimit të kërkesës rrjedh nga data e kompletimit të kërkesave/kushteve e jo nga data e parashtrimit të kërkesës.

7. Për më tepër ka deklaruar se e ka respektuar afatin e parashikuar për shqyrtimin e kërkesës së Paditësit të parashtruar më datë 25.04.2014 sepse më datë 21.04.2014 përmes emailit e ka njoftuar paditësin se inspektimi i kushteve të zyrës së zhvendosur bëhet më datë 22.05.2014, mirëpo sipas Paditësit për shkak të problemeve teknike me email nuk kishin pranuar emalin, prandaj e ka kontaktuar përmes telefonit me menaxherin e administratës së Paditësit, dhe në koordinim me atë është ndryshuar plani i inspektimit më datë 26.05.2014. Ka shtuar se pretendimi i Paditësit lidhur me nxjerrjen e përsëritshme të aktit administrativ në kundërshtim e vërejtjet e gjykatës dhe për mos vërtetim të drejtë të gjendjes faktike nuk qëndrojnë dhe janë tërësisht të pa bazuara për faktin se vendimi i goditur është nxjerrë në rivendosje sipas aktgjykimit A.nr. 2198/2014 të vërtetuar me aktgjykimit A.nr. 254/2018 të Gjykatës së Apelit dhe bazohet në raportin e inspektimit të BQK-së të datës 08.02.2019, ngase Paditësi ka vepruar pa miratim paraprak të BQK-së në afat prej 70 ditëve duke filluar nga data e inspektimit 26.05.2014, e deri më datën e aprovimit të kërkesës nga BQK më datë 05.08.2014. Bazuar në nenin 105 par.1 nën par.1. i Ligjit nr. 04/8L-093 për banka IMF dhe IFJB.

## II. Provat e administruara dhe gjendja faktike e konstatuar

8. Me qëllim të konstatimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, gjykata i aprovoi të gjitha propozimet e palëve për administrimin e prova. Në këtë drejtim, në seancën për shqyrtimin kryesor u administruan provat si në vijim: kërkesa për hapjen e filjalës dhe për zhvendosje me nr. 769 e datës 29.04.2014 e paditësit dorëzuar tek i padituri; aprovimi i zhvendosjes së zyrës në Kamenicë, lëshuar nga i padituri për paditësin me nr. 214/564 me datë 11.08.2014; vendimi nr. 46-15/2014 i paditurës për paditësin; urdhërpagesa me nr. serik VII/2014/ho/1 e datës 29.07.2014; aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative A.nr. 2198/2014 i datës 23.01.2018; aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës- Departamenti për Çështje

Administrative AA.nr.254/2018 i datës 13.12.2018; vendimi nr. 06-04/2019 i të paditurit për paditësin; raporti i vizitës lidhur me verifikimin e operimit për paditësin në degën në Kamenicë për periudhën 26.05.2014 deri me 05.08.2014, i datës 08.02.2019; komunikimi me email i datës 21.05.2014; raporti për inspektimin e zhvendosjes së zyrës së paditësit dega në Kamenicë; lista e transaksioneve ditore nga data 01.04.2014 deri më 30.09.2014 e paditësit dega në Kamenicë; ditari i arkës ditore për periudhën 26.05.2014 deri më 05.08.2014 për paditësin; formulari i barazimit të keshit për periudhën 26.05.2014 deri më 05.08.2014; ditari i arkës kryesore për periudhën 27.05.2014 deri më 05.08.2014; bilanci i konsoliduar i të hollave në degë për periudhën 26.05.2014 deri më 05.08.2014; disbursimi për datat 27.05.2014 deri më 31.07.2014; komplet shkresat e lëndës të procedurës administrative të cilat i padituri i ka dorëzuar me përgjigje në padi në bazë të nenit 37.2 të LKA-së lidhur me nenin 43.1 të LKA-së.

9. Gjykata i analizoi të gjitha provat cekura më lartë në kuptim të nenit 8 të LPK-së dhe duke i zbatuar rregullat mbi vlerësimin e provave sipas nenit 322 të LPK-së lidhur me nenin 63 të LKA-së konstatoi gjendjen faktike të përshkruar më poshtë.
10. Paditësi përmes më 29.04.2014 e ka njoftuar të Paditurën për zhvendosjen e zyrës së saj në Kamenicë në adresë tjetër, duke e kërkuar aprovimin e kësaj zhvendosje. Këtë fakt gjykata e vërtetoi përmes kërkesë nr. 769 e datës 29.04.2014.
11. Më 21.05.2014 i Padituri përmes e-mailit e kishte njoftuar Paditësin se për datën 22.05.2014 planifikon të kryej inspektimin, ndërsa Paditësi nuk i kishte kthyer përgjigje fare. Këtë fakt gjykata e vërtetoi përmes e-mailit të sapo cekur.
12. E paditura më datë 26.05.2014, ka bërë inspektimin e zhvendosjes së zyrës së Paditësit, dhe kishte konstatuar se ai ka filluar punën më 26.05.2014 pa aprovim paraprak të BQK-së.
13. E paditura me datë 24.07.2014 ka marr vendim 46-15/2014, me të cilin i ka shqiptuar gjobë prej 15,000.00€, me arsyetim se gjatë inspektimit është vërejtur se kjo zyrë ka filluar punën më 26.05.2014 pa aprovim paraprak të BQK-së. Këtë fakt gjykata e vëretoi përmes vendimit të sapo cekur. Këtë gjobë paditësi më datë 29.07.2014 ka bërë pagesën e gjobës administrative, siç rrjedh nga urdhërpagesa me nr. serik VII/2014/ho/1 e datës 29.07.2014.

14. Më 05.08.2014 i Padituri përmes parashtresës e kishte njoftuar se ia ka aprovuar kërkesën për zhvendosje të zyrës në lokacionin në rrugën Adem Jashari p.nr. në Kamenicës. Këtë fakt gjykata e konstatoi përmes parashtresës nr. 214/564 të së Paditurit.
15. Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, duke vendosur sipas padisë së Paditësit, përmes aktgjykimit A.nr. 2198/2014 të datës 23.01.2018 e kishte anuluar vendimin 46-15/2014 të datës 24.07.2014 dhe e kishte kthyer çështjen në rishqyrtim dhe rivendosje.
16. I padituri, duke vepruar sipas aktgjykimit të cekur më lartë ka marr vendim e goditur nr. 06-04/2019 për shqiptimin e masës administrative ndaj Paditurit në vlerë totale prej 15,000.00€, të cilën e kishte konsideruar të paguar, meqë i Padituri e kishte përmbushur këtë detyrim sipas vendimit të mëhershëm.
17. Gjykata gjithashtu konstaton se Paditësi kishte filluar punën në filialin e ri në Kamenicë më 25.05.2014, pra 78 ditë para se ta marrë aprovimin e të Padituri për ndërrim të lokacionit. Ky fakt nuk ishte kontestues mes palëve, por vërtetohet edhe provat e administruara.

### III. Vlerësimi meritor i rastit

18. Gjykata pas i mori parasysh të gjitha pretendimet e ndërgjyqësve, gjendjen faktike të konstatuar, si dhe pas analizimit të dispozitave juridike të shqyrtuara më poshtë, erdhi në përfundim se kërkesëpadia e Paditësit është e pabazuar në ligj.
19. Në rend të parë, gjykata e shqyrtoi kompetencën e të Padituri për nxjerrjen e vendimit të goditur, dhe gjeti se ai në bazë të nenit 36 para. 1 para. 12 dhe 67 të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore (këtu e tutje LBQ) dhe nenit 105 para. 1 nënpara. 1 dhe 6 të Ligjit 04/L093 për Banka, Institucione Mikrofinanciare dhe Institucione Jobankare (këtu e tutje LBIMIJ) ka pasur të drejtë të nxjerr vendimin e goditur.
20. Gjykata gjithashtu vlerësoi se i Padituri e ka zbatuar procedurën administrative në përputhje me LPPA-në dhe dispozitat procedurale të paraparë me ligjet e veçanta, të cekur në këtë aktgjykim. Në këtë aspekt, gjykata e vlerëson si pabazuar pretendimin e Paditësit se i Padituri në kuptimin procedurale ka qenë i obliguar që fillimisht t'ia dorëzoj një rekomandim lidhur me shkeljet e tij, ndërsa pasi që rekomandimi të bëhej i

plotfuqishëm, ka mundur të shqiptoj dënimin administrativ, sipas nenit 4.3 të Rregullores për Hapjen dhe Mbylljen Brenda dhe Jashtë Republikës së Kosovës të Degëve dhe Subjekteve të Varura të Bankave (këtu e tutje Rregullorja). Në rend të parë, sipas kësaj gjykate, Rregullorja nuk mund të zbatohet në rastin konkret për faktin se sipas nenit 1 para. 1 të saj *“Qëllimi i kësaj Rregulloreje është të përcaktojë kushtet, kërkesat, procedurat dhe afatet që duhet ndjekur për hapjen dhe mbylljen e degëve të bankave brenda Republikës së Kosovës dhe hapjen e degëve bankare ose subjektit të varur jashtë Republikës së Kosovës”*, ndërsa në para. 2 ka përcaktuar se *“Kjo Rregullore aplikohet për të gjitha bankat e licencuara nga BQK-ja për të operuar në Republikën e Kosovës”*. Siç vërehet, Rregullorja ka fushëveprim juridik vetëm sa i përket bankave dhe degëve të tyre, ndërsa Paditësi nuk është bankë por institucion mikrofinanciar. Për këtë arsye, neni 3 dhe 4 i Rregullores nuk gjen zbatim në rastin konkret. Gjithashtu, obligimi i tillë nuk mund të zbatohet për bordin e të Paditurit, pasi sipas nenit 67 para. 5 i LBQ, sipas të cilit *“Bordi Ekzekutiv nuk kërkohet të zbatojë paragrafin 4. të këtij neni kur përcakton ndëshkimet e përmendura në nenin 12, paragrafi 3, nenin 23, paragrafi 1 dhe nenin 25 të këtij ligji”*.

21. Gjykata vlerëson se i Padituri në vendimin e kundërshtuar e ka konstatuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike, si dhe nga faktet e vërtetuara ka ardhur në përfundimin e drejtë të gjendjes faktike, e cila përkon në tërësi me gjendjen faktike të konstatuar nga kjo gjykatë.
22. Përveç kësaj, gjykata vlerëson se i Padituri në mënyrë të drejtë e ka zbatuar të drejtën materiale administrative. Në këtë drejtim, sipas nenit 95 para. 1 nënpara. 2 të LBIMIJ-së *“1.Transaksionet në vijim të institucionit mikrofinanciar ose institucionit jobankar financiar kërkojnë miratimin paraprak nga BQK-ja: (...) 1.2.ndryshimi i lokacionit”*. Siç rrjedh nga kjo normë, sa herë një institucion mikrofinanciar, siç është Paditësi, dëshiron ta ndërroj lokacionin, atëherë ai duhet paraprakisht ta merr aprovimin e të Paditurit. Në anën tjetër, siç ka sqaruar edhe më lartë, Rregullorja juridikisht është e pazbatueshme në rastet e institucioneve mikrofinanciare dhe jo bankare, rrjedhimisht procedura e paraparë me atë rregullore nuk mund të gjej zbatim në rastin konkret
23. Për më tepër, gjykata sqaron se as neni 46 dhe/ose 100 i LPPA-së nuk mund të zbatohen në rastin konkret, gjegjësisht nuk mund të konsiderohet se i Padituri e ka aprovuar në heshtje kërkesën e Paditësit për ndërrim të lokacionit, pasi LPPA ka hyrë në fuqi më 21.06.2017, ndërsa dispozitat e heshtjes administrative kanë filluar të zbatohen 2 vite

pasi është hy në fuqi LPPA, siç përcakton neni 160 para. 2 dhe 161 i LPPA-së. Në anën tjetër, Ligji nr. 02/L-28 për Procedurën Administrative, i cili ka qenë në fuqi në kohën kur Paditësi kishte aplikuar për ndërrim të lokacionit, nuk e kishte paraparë heshtjen si aprovim. Përkundrazi, ai ligj kishte paraparë që në rast të heshtjes administrative, atëherë pala ka të drejtë të ushtroj mjetin e goditjes (ankesë, ose nëse ankesa nuk ka qenë e lejuara atëherë padi për hapjen e konfliktit administrativ) sikur të ishte refuzuar kërkesa e palës dhe të kërkoj që të detyrohet autoriteti kompetent administrativ që të nxjerrë vendimin sipas kërkesës.

24. Nga kjo rrjedh se, Paditësi në asnjë rrethanë nuk ka qenë i autorizuar që të filloj punën në filialin e ri, pa e marrë aprovimin paraprak të së Paditurit. Meqenëse ai veç e kishte filluar punën në lokalin e ri, përkundër faktit se nuk e kishte aprovimin e të Paditurit, atëherë ai ka vepruar në kundërshtim me nenin 95 para. 1 nën para. 2 të LBIMIJ-së.
25. Shkeljet, sanksionet dhe masat përmirësuese të LBIMIJ-së rregullohen në rend të parë me nenin 105 të tij, i cili shprehimisht ka sanksionuar se *“1.BQK-ja mund të ndërmarrë një apo më shumë nga veprimet vijuese apo të shqiptojë dënimet vijuese lidhur me institucionin mikrofinanciar ose institucionin jobankar financiar, nëse BQK-ja, në konstatimet e veta, konstaton se institucioni mikrofinanciar ose institucionin jobankar financiar apo ndonjëri nga menaxherët e lartë ose drejtorët e tij ose mbajtësit e interesit të rëndësishëm e kanë shkelur një dispozitë të ndonjë rregulloreje a urdhërese të BQK-së, ose janë angazhuar në praktika të pasigurta dhe të pabazuara: 1.1.jep vërejtje me shkrim; 1.2.kërkon nga institucioni mikrofinanciar ose institucioni jobankar financiar që të paraqesë një plan përmirësues; 1.3.bën marrëveshje me shkrim me bordin e drejtorëve për sigurimin e një programi për veprime përmirësuese; 1.4.cakton afate dhe/ose vendos kufizime të aktiviteteve dhe veprimeve të institucionit mikrofinanciar ose institucionit jobankar financiar; 1.5.nxjerr urdhëresa me shkrim për ndaljen dhe shmangien nga shkeljet e tilla, si dhe ndërmerr veprime përmirësuese; 1.6.shqipton gjoba për institucionin mikrofinanciar ose institucionin jobankar financiar apo menaxherët e lartë, drejtorët, aksionarët kryesor ose për mbajtësit e interesit të rëndësishëm, në shuma prej njëqind (100) deri në njëmijë (1,000) euro për çdo ditë sa vazhdon shkelja; 1.7.cakton një këshilltar për institucionin mikrofinanciar ose institucionin jobankar financiar; 1.8.suspendon përkohësisht apo shkarkon menaxherët e lartë apo anëtarin ose anëtarët e tij, bordin e drejtorëve apo ndonjë anëtar ose anëtarë të tij; 1.9.cakton një administrator të përkohshëm në vend të menaxhmentit*



*aktual dhe bordit të drejtorëve; dhe 1.10.anulon regjistrimin e institucionit mikrofinanciar ose institucionit jobankar financiar dhe cakton një likuidator në pajtim me dispozitat e këtij ligji*". Nga këto dispozita kuptohet se i Padituri ka qenë i autorizuar që të shqiptoj gjobë në baza ditore, për aq sa ka zgjatur shkelja. Në këtë drejtim, gjykata vlerëson se i Padituri ka dhënë arsye të mjaftueshme lidhur me lartësinë e gjobës, kur ka sqaruar se gjoba është llogaritur për 70 ditë nga 214,29€ në ditë duke filluar nga dita e inspektimit e datës 29.04.2014 deri në ditën e aprovimit të ndërrimit të lokacionit, ashtu që shuma totale ka arritur vlerën prej 15,000.00€ (70 ditë nga 214.29€= 15,000.00€). Gjithashtu, gjykata vlerëson se me dhënien e arsyetimit, i Padituri e ka përmbushur aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, përmes të cilit akti fillestar ishte anuluar dhe çështja ishte kthyer në rivendosje te organi administrativ për shkak të mungesës së arsyetimit.

26. Në anën tjetër, gjykata vlerëson proporcionale gjobën e shqiptuar, duke marrë parasysh se përshtatshmëria e lokaleve, si kriter i paraparë edhe për licencim të institucioneve mikrofinanciare sipas nenit 92 para. 1 lidhur me nenin 8 para. 3 nënpara. 2 dhe para. 5 nënpara. 3 dhe 4 të LBIMIJ-së, të cilët lidhen edhe me mundësinë që i Padituri të ushtroj mbikëqyrjen mbi institucionet mikrofinanciare, si dhe duke marrë parasysh faktin që Paditësi për mbi dy muaj ka zhvilluar aktivitetin ekonomik, përkundër faktit se e ka ditur ose është dashur ta di se është duke vepruar në kundërshtim me LBIMIJ.
27. Gjykata e vlerësoi padinë e Paditësit edhe në raport me pikën III. të dispozitivit të vendimit të goditur dhe erdhi në përfundim se ajo është e palejuar.
28. Në këtë drejtim, gjykata gjeti se pika III. e vendimit të goditur i referohet vërejtjes që i ka shqiptuar i Padituri menaxherit të atëhershëm të Paditësit. Gjykata gjithashtu vërejtë se Paditësi në asnjë moment gjatë procedurës nuk ka deklaruar se me padi nuk kërkohet shqyrtimi i ligjshmërisë lidhur me pikën III. të dispozitivit të vendimit të goditur, përkundrazi ka ngritur pretendime edhe për paligjshmërinë e kësaj pjese të vendimit. Gjykata rikujton se si paditës në këtë procedurë është vetëm Finca, por jo edhe menaxheri i atëhershëm, që nënkupton se Finca ka kërkuar anulimin edhe të pikës III. të vendimit të goditur.
29. Gjykata vlerëson se pika III. e dispozitivit të vendimit të goditur nuk e prek asnjë interes të Paditësit, si dhe nuk e cakton asnjë detyrim për të, por vetëm për menaxherin e tij të

dikurshëm, cili nuk është palë në procedurës, ndonëse e ka pasur të mundshme që të ushtroj padi kundër kësaj pike vet ose së bashku me Paditësin.

30. Duke qenë kështu, gjykata vlerëson se Paditësi nuk ka të drejtë të kërkoj anulimin e një akti administrativ në pjesën, e cila nuk i cenon të drejtat e tij e as nuk i cakton atij ndonjë detyrim. Këtë qëndrim gjykata e mbështet në nenin 10 para. 1 të LKA-së, sipas të cilit *“Të drejtë për të nisur konfliktin administrativ ka personi fizik si dhe personi juridik, nëse vlerëson se me aktin administrativ përfundimtar në procedurën administrative, i është shkelur ndonjë e drejt apo interes ligjor”*, si dhe nenin 34 para. 1 nënpara. 3 të LKA-së, i cili ka përcaktuar se *“Gjykata e hedh poshtë padinë me vendim, nëse konstaton se: (...) është e qartë se me aktin administrativ, që kontestohet me padi, nuk preken të drejtat e paditësit ose interesi i tij i drejtpërdrejtë i bazuar në ligj”*
31. Prandaj, gjykata vlerësoi se është e qartë që me pikën III. të dispozitivit të goditur nuk preken interesat e Paditësit e as nuk caktohet ndonjë detyrim në raport me të, rrjedhimisht në bazë të nenit 34 para. 1 nënpara. 3 të LKA-së e hodhi poshtë padinë lidhur me këtë pjesë
32. Përfundimisht gjykata sqaron se asnjëri nga nenet e cituara më lartë të LBIMIFJ-së nuk është prekur nga aktgjykimi nr. ref.: AGJ403/13 në rastin KO.nr.97/12 të datës 12.04.2013 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, me të cilin kjo fundkit ka vendosur që e nenet 90, 95 (1.6), 110 dhe 116 LBIMIFJ-së janë të pavlefshme, rrjedhimisht janë të zbatueshëm.
33. Prandaj, meqenëse i Padituri ka qenë kompetent për të nxjerr vendimin e goditur, procedura që i ka paraprirë nxjerrjes së aktit administrativ të goditur është zbatuar në tërësi sipas rregullave të procedurës administrative, duke qenë se i Padituri ka dhënë arsyetim të mjaftueshëm për të gjitha çështjet relevante të rastit dhe e ka batuar aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, duke marrë parasysh se i Padituri e ka konstatuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike, si dhe nga faktet e vërtetuara ka ardhur në përfundimin e drejtë të gjendjes faktike, siç është sqaruar edhe në pjesën e gjendjes faktike në këtë arsyetim, gjykata vjen në përfundim se nuk është plotësuar asnjë kusht ligjore nga LPPA dhe LKA për anulimin e aktit administrativ të goditur, rrjedhimisht e refuzoi kërkesëpadinë e Paditësit.
34. Gjykata i pati parasysh edhe pretendimet tjera të Paditësit, por gjeti se ato nuk ishin relevante për të vendosur ndryshe nga dispozitivi i këtij aktgjykimi.

35. Për këto arsye, bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 46 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata Komerciale e Kosovës

Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.62/24

Gjyqtari

---

Arben Toska

UDHËZIMI PËR MJETIN E GODTIJES: Kundër këtij aktgjykimit mund të paraqitet ankesë brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit. Ankesa në formë të shkruar dhe në ekzemplarë të mjaftueshme për gjykatën dhe secilën palë tjetër dorëzohet në këtë gjykatë, ndërsa i drejtohet Dhomës së Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale.